

RREGULLAT E PROMOCIONIT **"Galaxy Watch5 dhe Galaxy Watch5 Pro"**

Data e publikimit dhe e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave: 10.08.2022.

Përpara se të blini një nga pajisjet Galaxy Watch5 ose Galaxy Watch5 Pro, ju lutem lexoni rregullat e këtij Promocioni (në vijim referuar si "**Rregullat**"):

1. Organizatori i Promocionit

Samsung Electronics Austria GmbH, me seli në Vjenë në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri dhe regjistruar me numër regjistrimi FN 217924b (në vijim referuar si "**Samsung**"), organizon porositjen paraprake të pajisjeve Galaxy Watch 5 dhe Galaxy Watch5 Pro (në vijim "**Pajisjet**").

2. Periudha e promocionit dhe pjesëmarrësit

Porositja paraprake e Pajisjeve është e disponueshme për blerësit privatë dhe biznes në territorin e Republikës së Shqipërisë që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këto Rregulla.

Kohëzgjatja e promocionit ("**Periudha e Promocionit**") për Pajisjen është nga data 10.08.2022 deri në 25.08.2022.

3. Përfitimet nga Promocioni

Blerësit privatë dhe biznes të cilët, gjatë Periudhës së Promocionit, blejnë një nga Pajisjet nëpërmjet faqes online të njërës prej partnerëve të shitjes së Samsung të listuar në këto Rregulla, do të kenë të drejtë të përfitojnë dhuratë një palë kufje Samsung Galaxy Buds Live (në vijim "**Dhurata**").

4. Kushtet për përfitim të drejtave nga Promocioni

Është i mundur fitimi i Dhuratës nga blerësit e Pajisjeve, me kusht përmbushjen në mënyrë kumulative të kushteve vijuese:

- Blerësi porosit Pajisjen gjatë Periudhës së Promocionit përcaktuar në pikën 2 të këtyre Rregullave;
- Pajisja porositet në faqen web të partnerit të autorizuar të shitjeve të Samsung në territorin e Republikës së Shqipërisë; Lista e partnerëve të autorizuar përcaktohet në pikën 8 të kësaj Rregulloreje;
- Blerësi porosit/blen Pajisjen si përdorues fundor; Përdoruesit fundorë janë personat fizik ose juridik në territorin e Republikës së Shqipërisë të cilët kanë porositur/blerë Pajisjen për qëllimet e tyre vetjake dhe jo me qëllim shitjen apo shpërndarjen e mëtejshme;
- Pajisjen e blerë, blerësi e regjistron në faqen web të Samsung jo më vonë se data 20.09.2022, në përputhje me këto Rregulla.

5. Regjistrimi i Pajisjes

Parakushti për marrjen e Dhuratës është regjistrimi i Pajisjes së blerë gjatë Periudhës së Promocionit. Regjistrimi duhet të kryhet në faqen web www.samsung.com/al/offer/preorder-galaxy-watch5.

Procesi i regjistrimit përfshin vendosjen e të dhënave të nevojshme për regjistrimin e suksesshëm. Të dhënat që mblidhen me qëllim që blerësi të ketë të drejtën të përfitojë Dhuratën, dhe me qëllim dërgimin e Dhuratës pas regjistrimit të suksesshëm janë:

- Emri dhe mbiemri i blerësit të Pajisjes ose emri i shoqërisë,
- Adresa e e-mailit e blerësit të Pajisjes,
- Adresa e banimit / adresa e selisë së blerësit të Pajisjes në territorin e Republikës së Shqipërisë (me qëllim dërgimin e Dhuratës),

- Paraqitje / skanim i faturës tatimore për pajisjen e blerë.

Duke klikuar mbi butonin e dërgimit, blerësi i dërgon të dhënat Samsung dhe nënkontraktuesve të tij me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve, pra nëse blerësi ka fituar të drejtën për të marrë Dhuratën, dhe blerësit jep gjithashtu pëlqimin e shprehur për përdorimin e të dhënave të tij personale në përputhje me parashikimet e këtyre Rregullave. Pëlqimi i blerësit është i domosdoshëm që procesi i regjistrimit të konsiderohet i suksesshëm.

6. Dorëzimi i Dhuratës

Dorëzimi i Dhuratave, me kusht që të jetë kryer me sukses regjistrimi në faqen web të Samsung sipas kësaj Rregulloreje, do të kryhet gjatë periudhës deri në 31.10.2022, në adresën e vendosur gjatë regjistrimit në faqen web të Samsung, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Dhuratat do të dorëzohen me shpenzimet e Organizatorit.

7. Dorëzimi i Pajisjes së blerë

Pajisjet që janë objekt i këtij Promocioni dhe që janë blerë gjatë Periudhës së Promocionit, e në përputhje me Rregullat e këtij Promocioni, do t'u dorëzohen blerësve nga partnerët e shitjeve të Samsung nga të cilët janë blerë. Afati, koha dhe mënyra e dorëzimit të Pajisjeve të blera përcaktohen në mënyrë të pavarur nga partnerët e shitjeve të Samsung.

8. Partnerët e Autorizuar të shitjeve Samsung

One Telecommunications Sh.a.
Neptun SH.P.K.
Globe Shops SH.P.K.
Vodafone Albania Sh.a.

9. E drejta e ndryshimit të kushteve të promocionit

Samsung rezervon të drejtën të ndryshojë këto Rregulla në çdo kohë, për arsye të justifikuara, me detyrimin që t'i publikojë pa vonesë.

POLITIKAT E MBROJTJES SE TË DHËNAVE PERSONALE

Data e hyrjes në fuqi: Maj 2018

Samsung Electronics Austria GmbH dhe shoqëritë e lidhura (në vijim: "Samsung", "ne", "jona") di se sa e rëndësishme është privatësia për stafin, furnizuesit, blerësit tanë dhe të gjithë të tjerët me të cilët bashkëpunojmë, dhe dëshirojmë të jemi të qartë lidhur me mënyrën e mbledhjes, përdorimit, përhapjes, transferimit dhe ruajtjes së të dhënave personale. Në vijim janë pyetjet kryesore lidhur me Politikën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

1. Qëllimi
2. Përgjegjësia për zbatim
3. Detyrimet tona
4. Përkufizime
5. Parimet e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
6. Kategori të veçanta të të dhënave personale
7. Ndarja e të dhënave personale (përfshirë transferimet jashtë Zonës Ekonomike Europiane)
8. Profilizimi dhe vendimmarrja automatike
9. Marketingu direkt
10. Mbajtja e regjistrimeve
11. Të drejtat individuale të subjektit të të dhënave personale
12. Procedura në rast të thyerjes së sigurisë së të dhënave personale
13. Përditësimet e politikave
14. Informacion i dobishëm kontakti

1. Qëllimi

Këto politika përcaktojnë rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe kushtet ligjore që duhet të plotësohen lidhur me marrjen, trajtimin, përpunimin, ruajtjen, transmetimin dhe asgjësimin e të dhënave personale.

Llojet e informacionit që trajtojmë përfshijnë detajet e anëtarëve të stafit aktual, të mëparshëm apo potencial, furnizuesve, klientëve dhe të tretëve me të cilët ndërveprojmë. Të dhënat e mbajtura në letër ose kompjuter i nënshtrohen masave të mbrojtjes ligjore të listuara në Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe legjislacionin e zbatueshëm, të cilat përcaktojnë kufizimet lidhur me si mund të përdorim këtë informacion.

Ruajtja e standardeve më të larta lidhur me trajtimin e të dhënave personale është përgjegjësi si kolektive, ashtu edhe personale, dhe këto politika zbatohen lidhur me mënyrën si ne marrim, përdorim, ruajmë dhe përpunojmë në çdo mënyrë të dhënat personale që përdorim gjatë ushtrimit të aktivitetit tonë. Këto përfshijnë një përmbledhje të detyrimeve tona kryesore lidhur me të dhënat personale të cilat zbatohen për ne si organizatë, duke përfshirë pritshmërinë që edhe ju të luani rolin tuaj për t'i zbatuar.

Këto politika për mbrojtjen e të dhënave personale zbatohen për çdo punonjës të Samsung si dhe çdo personel tjetër që i ofron shërbime Samsung (duke përfshirë por pa u kufizuar në stafin e kontraktorëve dhe agjentëve) (bashkërisht referuar si "Anëtarët e Stafit"). Të gjithë anëtarëve të stafit u kërkohet të sigurohen që kuptojnë

këto politika dhe i zbatojnë në lidhje me çdo informacion personal të cilin aksesojnë gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

2. Përgjegjësia për zbatim

Përgjegjësia për monitorimin e zbatimit të mbrojtjes së të dhënave personale, duke përfshirë zbatimin e këtyre politikave, është e Zyrarit tonë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, informacionet e kontaktit të të cilit mund të gjenden në fund të këtyre Politikave.

Personat në pozicione menaxhuese mbajnë përgjegjësi për zbatimin e mbrojtjes së të dhënave personale të ekipeve të tyre.

Nëse besoni se këto politika nuk janë ndjekur për sa i përket të dhënave personale tuaja ose të personave të tjerë, ju duhet ta ngrini këtë çështje me drejtuesin tuaj apo me departamentet e burimeve njerëzore apo departamentin ligjor.

3. Detyrimet tona

Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashikon gjopa në shuma të konsiderueshme ndaj subjekteve që shkelin parashikimet e saj. Në varësi llojit të shkeljes, subjektet mund të gjobiten me shuma më të larta se 20 milion € ose 4% të xhiros totale globale vjetore të vitit të shkuar financiar. Këto penalitete të larta rrisin ekspozimin ndaj riskut lidhur me zbatimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

4. Përkufizime

Përkufizimet e mëposhtme mund të ndihmojnë në leximin e këtyre politikave:

Të dhënat për rekordet kriminale janë informacionet lidhur me veprat penale dhe dënimet e një personi të caktuar.

Kontrolluesit e të dhënave personale janë personat ose entet të cilat përcaktojnë qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale. Këta janë përgjegjës për përcaktimin e praktikave dhe politikave në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ne jemi kontrolluesit e të gjitha të dhënave personale të përdorura gjatë ushtrimit të aktivitetit tonë. Furnizuesit tanë, kontraktorët dhe konsulentët mund të jenë gjithashtu përpunues të dhënash personale.

Termi **Subjekt i të Dhënave Personale**, për qëllimet e këtyre Politikave, përfshin të gjithë individët e gjallë, të dhënat personale të të cilëve ne mbajmë, duke përfshirë klientë, furnizues, agjentë, investitor si dhe anëtarë të stafit tonë, aktual, të mëparshëm apo potencial. Subjekti i të dhënave personale nuk është detyrimisht shtetas apo rezident i Republikës së Shqipërisë. Të gjithë subjektet e të dhënave personale kanë të drejta të caktuara ligjore lidhur me të dhënat e tyre personale.

Termi të **Dhëna Personale** nënkupton të dhënat lidhur me një person të gjallë i cili mund të identifikohet bazuar në ato të dhëna (ose bazuar në ato të dhëna apo informacione të tjera që posedojmë). Të dhënat personale mund të jenë faktike (të tilla si emri, adresa apo ditëlindja) ose mund të jenë një opinion (të tilla si vlerësim impakti). Përkufizimi i "të dhëna personale" përdorur në Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe në legjislacionin e zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale, është shumë i gjerë dhe lejon një numër të madh identifikuesish personal që të klasifikohen si të dhëna personale. Kjo përfshin emrin, numrin e identifikimit dhe informacionin e vendndodhjes.

Përpunimi është çdo veprim që përfshin përdorimin e të dhënave personale. Në të përfshihen marrja, përdorimi, observimi, regjistrimi apo mbajtja e të dhënave personale, ose kryerja e çdo veprimi ose grupi veprimesh duke përfshirë organizimin, modifikimi, tërheqjen, përdorimi, përhapjen, shuarjen apo asgjësimin e të dhënave personale. Përpunimi përfshin gjithashtu edhe transferimin e të dhënave personale te palë të treta.

Të dhëna personale të kategorisë së veçantë (njohur më parë si të dhëna personale sensitive) përfshijnë informacionin lidhur me origjinën racore apo etnike të një personi, opinionin politik të tij apo të saj, besimet fetare apo të ngjashme, anëtarësi në organizata, shëndetin fizik apo mendor apo gjendje, ose jetën seksuale, si dhe të dhënat gjenetike dhe biometrike, kur përdoren për të identifikuar një individ.

5. Parimet e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Çdo person që përpunon të dhëna personale duhet të zbatojë parimet e zbatueshme të praktikës së mirë të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të cilën Samsung detyrohet ta zbatojë.

- Ne do të përpunojmë të dhënat personale në përputhje me ligjin, me drejtësi dhe transparencë (shih seksionin "Ligjshmëria, drejtësia dhe transparencë").
- Ne do të mbledhim të dhënat personale për qëllime të caktuara, eksplicite dhe të ligjshme; ne nuk do t'i përpunojmë në ndonjë mënyrë që nuk do të ishte në përputhje me këto qëllime (shih seksionin "Kufizimi i Qëllimit dhe Minimizimi i të Dhënave").
- Ne do të përpunojmë të dhënat personale të cilat janë të përshtatshme, relevante dhe të kufizuara në atë që është e nevojshme për qëllimin e përpunimit (shih seksionin "Kufizimi i Qëllimit dhe Minimizimi i të Dhënave").
- Ne do të sigurojmë që të dhënat personale janë të sakta dhe, kur është e nevojshme, të përditësuara; kur të dhënat janë të pasakta, ne do të ndërmarrim të gjitha hapat e nevojshme për të fshire apo korigjuar pa vonesa këto të dhëna, duke pasur parasysh qëllimet për të cilat këto të dhëna janë përpunuar (shih seksionin "Saktësia").
- Ne nuk do të ruajmë të dhëna personale në një formë që lejon identifikimin e individit të cilat i përkasin, për një periudhë më të gjatë nga sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohet (shih seksionin "Kufizimi i Ruajtjes").
- Ne do të përdorim masat teknike apo organizative të përshtatshme për të siguruar sigurinë e të dhënave personale, të cilat do të përfshijnë mbrojtjen e tyre ndaj përpunimit të paautorizuar apo ilegal apo humbjes, asgjësimit apo dëmtimit aksidental (shih seksionin "Integriteti dhe Konfidencialiteti").

Në vijim gjeni informacion shtesë për secilin nga këto parime.

5.1 Ligjshmëria, drejtësia dhe transparencë

Legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale ka qëllim jo parandalimin e përpunimit të të dhënave personale, por të sigurojë që kryhet me drejtësi dhe pa paragjykuar të drejtat e subjektit të të dhënave personale.

Në mënyrë që të dhënat personale të përpunohen në përputhje me ligjin, është e nevojshme të përmbushet një nga kushtet ligjore për përpunimin. Këto kushte përfshijnë: subjekti i të dhënave duhet të japë pëlqimin e shprehur dhe me vullnet të lirë për përpunimin; përpunimi kërkohet në përputhje me ligjin; përpunimi është i nevojshëm për zbatimin e kontratës që kemi lidhur me subjektin e të dhënave personale; ose përpunimi është i nevojshëm për interesin e ligjshëm të Samsung apo personit të cilit i zbulohen të dhënat personale (përveç rastit kur këto interesa janë më pak të rëndësishme se sa të drejtat apo liritë themelore të individit. Përpara se të nisim përpunimin e të dhënave personale (për shembull, përpara mbledhjes së të dhënave personale nga një person), ne shqyrtojmë të dhënat për përpunimin e të dhënave, si dhe përse nevojiten ato të dhëna. Gjithashtu, ne identifikojmë bazën ligjore që na lejon të marrim dhe përpunojmë këtë informacion në mënyrë të ligjshme.

Disa informacione duhet t'i sigurohen subjektit të të dhënave personale në përputhje me ligjin, duke përfshirë (por pa u kufizuar në) kush është kontrolluesi i të dhënave personale, qëllimi(et) për të cilin përpunohen të

dhënat personale, baza ligjore për përpunimin e të dhënave, identitetin e secilit subjekt të dhënash të cilit të dhënat personale mund t'i zbulohen apo transferohen, si dhe të drejtat e subjektit të të dhënave personale lidhur me të dhënat e tij personale. Ky informacion mund të jepet nëpërmjet njoftimeve të përshtatshme për privatësinë ose nëpërmjet njoftimeve të drejta për përpunimin e të dhënave personale.

5.2 Kufizimi i Qëllimit dhe Minimizimi i të Dhënave

Të dhënat personale mund të përpunohen vetëm për nevojat specifike për të cilat subjekti i të dhënave personale është njoftuar në kohën kur janë marrë të dhënat personale, ose për çdo qëllim tjetër të lejuar shprehimisht nga legjislatiioni për të dhënat personale. Kjo do të thotë që të dhënat personale nuk mund të mbliidhen për një qëllim dhe të përdoren për një qëllim tjetër. Nëse është e nevojshme të ndryshohet qëllimi për të cilin përpunohen të dhënat personale, subjekti i të dhënave personale do të njoftohet lidhur me qëllimin e ri, përpara çdo lloj përpunimi.

5.3 Saktësia

Të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara. Informacioni i pasaktë konsiderohet jo korrekt dhe për këtë arsye është e nevojshme të merren hapa për të kontrolluar saktësinë e çdo të dhëne personale në vendin e mbledhjes së tyre, dhe të vazhdojë në këtë mënyrë rregullisht në intervale të caktuara kohe. Të dhënat personale të pasakta ose të papërditësuara duhet të asgjësohen. Nëse vini re se të dhënat tuaja personale të cilat ne përpunojmë janë të pasakta, ju duhet të njoftoni menaxherin/personin e kontaktit për përpunimin e të dhënave dhe të merrni hapat e nevojshme për të asgjësuar ndryshimin, duke pasur parasysh kërkesat e politikave tona për mbajtjen e të dhënave, aty ku është e nevojshme.

5.4 Kufizimi i ruajtjes

Të dhënat personale duhet të mbahen në një format i cili nuk lejon identifikimin e subjektit të të dhënave për më tepër kohë nga sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur të dhënat personale. Kjo do të thotë se të dhënat personale duhet të asgjësohen ose fshihen nga sistemet tona kur nuk nevojiten më, ose të dhënat personale duhet të editohen nga i njëjti.

Pas mbarimit të periudhës së mbajtjes, përveç kur ka arsye të vlefshme biznesi për mbajtjen edhe pas këtij afati (për shembull nëse subjekti i të dhënave personale ka paraqitur padi kundër nesh dhe të dhënat personale të mbajtura kanë lidhje me këtë padi), rekordet që përmbajnë të dhëna personale do të fshihen në mënyrë të sigurt dhe do të asgjësohen efektivisht.

5.5 Integriteti dhe Konfidencialiteti

Ruajtja e sigurisë së të dhënave do të thotë garantimi i konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave personale, në përputhje me përkufizimet e mëposhtme:

- a) Konfidencialitet do të thotë që të dhënat mund të aksesohen vetëm nga persona të autorizuar për të përdorur të dhënat.
- b) Integritet do të thotë që të dhënat personale duhet të jenë të të sakta dhe të përshtatshme për qëllimin për të cilin janë përpunuar, si dhe të jenë të besueshme gjatë jetëgjatësisë së tyre (nuk mund të ndryshohen nga persona të paautorizuar).
- c) Disponueshmëri do të thotë që përdoruesit e autorizuar duhet të kenë mundësi të aksesojnë të dhënat nëse u nevojiten për qëllimet e lejuara. Prandaj, të dhënat personale duhet të ruhen në sistemin tonë qendror kompjuterik në vend që të ruhen në kompjutera personal individual.

Procedurat e sigurisë përfshijnë:

- a) **Kontrolli i hyrjeve.** Është e domosdoshme të raportohet çdo person i huaj që vihet re në ambientet me kontroll në hyrje.
- b) **Sigurimi i tavolinave dhe sirtarëve me kyç.** Mbani tavolinat dhe sirtarët e kyçur nëse mbajnë informacion sensitiv të çdo lloji. (Informacioni personal konsiderohet gjithnjë konfidencial.)

- c) **Metodat e asgjësimit.** Dokumentet në letër duhet të priten. Disketat dhe CD-ROM duhet të shkatërrohen fizikisht kur nuk nevojiten më.
- d) **Pajisjet.** Anëtarët e stafit të Samsung duhet të sigurohen që monitorët individual të mos shfaqin informacion konfidencial të kalimtarët, si dhe që mos të shfaqin kompjuterët e tyre personal kur janë të paruajtur.

6. **Kategori të veçanta të të dhënave personale**

Herë pas here mund të na duhet të përpunojmë kategori të veçanta të të dhënave personale.

Ne do të përpunojmë të dhëna personale të kategorive të veçanta vetëm kur kemi bazën ligjore për përpunimin e të dhënave personale (shih seksionin 5 të këtyre Politikave) dhe kur përmbushet një nga kushtet e veçanta për përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave personale. Këto kushte të veçanta përfshijnë, por nuk kufizohen në si vijon:

- a) Subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin e tij të shprehur.
- b) Përpunimi është i nevojshëm për qëllimin e shfrytëzimit të të drejtave ose detyrimeve të Samsung ose të subjektit të të dhënave personale në përputhje me legjislacionin e punës.
- c) Përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat thelbësore të subjektit të të dhënave dhe subjekti i të dhënave personale është në pamundësi fizike për të dhënë pëlqimin.
- d) Përpunimi i referohet të dhënave personale të cilat subjekti i të dhënave personale i ka zbuluar publikisht.
- e) Përpunimi është i nevojshëm për të provuar, përdorur ose mbrojtur pretendime ligjore.
- f) Përpunimi është i nevojshëm për shkak të interesit të madh publik.
- g) Përpunimi është i nevojshëm për të vlerësuar aftësinë për të punuar të punonjësit.

Kategoritë e veçanta të të dhënave personale nuk do të përpunohen nëse:

- a) Vlerësimi i mësipërm nuk kryhet; dhe
- b) Subjekti i të dhënave personale nuk informohet në mënyrë të përshtatshme (nëpërmjet njoftimi për privatësinë ose tjetër) lidhur me natyrën e përpunimit, qëllimet për të cilat kryhet dhe bazën ligjore.

7. **Ndarja e të dhënave personale (përfshirë transferimet jashtë Zonës Ekonomike Europiane)**

Të dhënat personale mundet vetëm të transferohen te palë të treta ofrues shërbimesh të cilat bien dakord që të zbatojnë politikat dhe procedurat e kërkuara si dhe çdo dispozitë kontraktore që ka lidhje, si dhe që zbatojnë masa të përshtatshme në përputhje me kërkesat.

Të dhënat personale mund të ndahen me një anëtar tjetër të grupit tonë (përfshirë bashkëpunëtorët tanë si dhe kompanitë e grupit holding së bashku me degët e tyre) nëse marrësit i nevojitet informacion për shkak të ushtrimit të aktivitetit, dhe nëse transferimi është në përputhje me kufizimet e zbatueshme lidhur me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale (shih më poshtë).

Legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale kufizon transferimin e të dhënave në shtete jashtë Zonës Ekonomike Europiane (ZEE) për të siguruar që niveli i nevojshëm i mbrojtjes së të dhënave personale nuk çenohet. Ju transferoni informacion personal të gjeneruar në një shtet përtej kufirit atëherë kur ju transferoni, dërgoni, shihni ose aksesoni atë informacion në një shtet tjetër. Është e domosdoshme të kërkohet miratim i shprehur nga departamenti ligjor/zyra e mbrojtjes së të dhënave personale e atij shteti, përpara transferimit të të dhënave personale përtej kufirit me qëllim që të kontrollohet nëse kushtet e nevojshme janë plotësuar.

8. **Profilizimi dhe vendimmarrja automatike**

Ekzistojnë mjaft kufizime lidhur me rrethanat në të cilat mund të merren vendime automatike për individë (kur vendimi kryhet ekskluzivisht automatikisht pa asnjë ndërhyrje nga njeriu). Ky është gjithashtu rasti për sa i përket profilizimit (përpunimi automatik i të dhënave personale me qëllim vlerësimin e disa aspekteve lidhur me individët, për shembull, nëse ky individ mund të pëlqejë një produkt të caktuar).

Kjo lloj vendimmarrjeje zbatohet vetëm kur është e nevojshme për zbatimin e kontratës, kur lejohet nga ligji, ose në rastet kur individ i jep pëlqimin e shprehur. Gjithashtu, individët kanë të drejtën të informohen lidhur me

vendimmarrjen dhe kanë disa të drejta të caktuara të cilat duhet tu komunikohen, përfshirë të drejtën për të kërkuar ndërhyrjen e një njeriu ose të kundërshtojnë një vendim, dhe ka disa kufizime të rrepta lidhur me përdorimin e të dhënave personale të kategorisë së veçantë për këtë lloj vendimmarrje.

Në çdo rast, çdo aktivitet profilizimi do të përpunohet në përputhje të plotë me legjislacionin e zbatueshëm.

9. Marketingu direkt

Ne zbatojmë kërkesat e rigorozë të mbrojtjes së të dhënave lidhur me marketingun direkt.

10. Mbajtja e regjistrimeve

Është e rëndësishme që të jemi të aftë të tregojmë se ne zbatojmë parimet e përpunimit të të dhënave personale. Kur kërkohet, ne mbajmë regjistrime të përshtatshme lidhur me trajtimin e të dhënave personale. Kjo mund të përfshijë në veçanti regjistrime të bazës ligjore për përpunimin e të dhënave personale, regjistrime të të dhënave dërguar subjekteve të të dhënave personale, si dhe regjistrime të përpunimit nga ana jonë të të dhënave personale.

11. Të drejtat individuale të subjekteve të të dhënave personale

Të dhënat duhet të përpunohen në përputhje me të drejtat e subjekteve të të dhënave. Subjektet e të dhënave kanë të drejtë:

- a) Nëse kanë dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave, të tërheqin pëlqimin në çdo kohë për përpunimin e të dhënave (dhe kjo duhet të jetë aq e lehtë për ta, sa është për të dhënë pëlqimin).
- b) Marrin informacion të qartë, transparent dhe lehtësisht të kuptueshëm lidhur me përdorimin e të dhënave të tyre personale (për këtë arsye ne japim informacion lidhur me privatësinë e të dhënave).
- c) Të kërkojnë akses në çdo të dhënë të mbajtur nga kontrolluesi i të dhënave personale.
- d) Të kërkojnë ndryshimin dhe korrigjimin e të dhënave të pasakta.
- e) Të kërkojnë që të dhënat e mbajtura nga kontrolluesi i të dhënave të fshihen kur përmbushen kushtet e caktuara nga legjislacioni i zbatueshëm.
- f) Të kërkojnë kufizimin e përpunimit kur përmbushen kushtet e caktuara nga legjislacioni i zbatueshëm.
- g) Të kërkojnë transferimin e të dhënave personale te një kontrollues tjetër kur përmbushen kushtet e caktuara nga legjislacioni i zbatueshëm.
- h) Të paraqesin kundërshtime për përpunimin e të dhënave personale kur përmbushen kushtet e caktuara nga legjislacioni i zbatueshëm.
- i) Të mos i nënshtrohen vendimmarrjes bazuar vetëm në përpunim automatik, përfshirë profilizimin, kur kjo shkakton pasoja ligjore apo pasoja të tjera për ta, përveç kur kanë dhënë pëlqim të shprehur, ose kur është e nevojshme për përmbylljen apo zbatimin e kontratave me ta.
- j) Të paraqesin ankim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me përpunimin e të dhënave nga ana jonë, duke përcaktuar detajet vijuese, edhe pse ne inkurajojmë subjektin e të dhënave që të na informojë lidhur me çdo shqetësim që ai ose ajo mund të ketë, me qëllim zgjidhjen e tij.

Kur viheni në dijeni të faktit se subjekti i të dhënave dëshiron të ushtrojë ndonjë nga të drejtat e tij, ju duhet të kontaktoni Zyrën e Çështjeve Ligjore/Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Ekziston mundësia që të merren hapat përshtatshëm për të identifikuar aplikuesin.

Kërkesa formale për akses te të dhënat personale nga subjekti i të dhënave personale (aplikuesi) lidhur me informacionin që Samsung Electronics Austria GmbH dega Kroaci zotëron për ta, mund të dërgohet me shkrim duke përdorur Shtojcën 2 (formular kërkesë i subjektit të të dhënave për akses te të dhënat). Megjithatë, kërkesa për akses te të dhënat paraqitur nga subjekti i të dhënave nuk është e detyrueshme për tu paraqitur formalisht apo me shkrim (për shembull, kërkesa mund të dërgohet nëpërmjet rrjeteve sociale ose me telefon). Çdo anëtar i stafit i cili merr një kërkesë (qoftë me formularin e dhënë ose jo) duhet t'ia dërgojnë menjëherë Zyrtarit të

Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe / ose Skuadrës së Përputhshmërisë Ligjore. Nëse jeni të paqartë nëse një kërkesë është paraqitur, ju duhet të diskutoni rrethanat me ta.

Zyrtari i Mbrojtjes së të Dhënave Personale do t'í përgjigjet çdo kërkesë brenda 30 ditësh nga marrja, me përjashtime të veçanta (me përjashtim të rastit kur legjislacioni i zbatueshëm parashikon një afat më të shkurtër, rast në të cilin do të zbatohet afati më i shkurtër). Nëse Samsung nuk mund të vërë në dispozicion informacionin personal të kërkuar, arsyet për këtë do të dokumentohen plotësisht dhe subjekti i të dhënave personale do të njoftohet me shkrim. Subjektit të të dhënave personale do t'í vihen në dispozicion detaje lidhur me autoritetin mbikëqyrës pranë të cilit mund të paraqitet ankimi, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

12. Procedura në rast të thyerjes së sigurisë të të dhënave personale

Thyerja e sigurisë së të dhënave personale është "një thyerje e sigurisë që rezulton në shkatërrim, humbje, ndryshim, përhapje e paautorizuar apo përpunim tjetër, aksidental ose me dashje". Shkelja nuk do të thotë detyrimisht se të dhënat personale janë përhapur pa autorizimin përkatës, por mund të nënkuptojë se dikush ka aksesuar nga brenda pa miratimin përkatës.

Ne kemi detyrimin që të njoftojmë organin rregullator përkatës dhe, në raste më të veçanta, subjektin e të dhënave personale të cilit i janë cënuar të dhëna të caktuara.

13. Autorizimet për aksesin te të dhënat personale

Autorizimi për të aksesuar të dhënat personale të kontrolluara dhe / ose përdorura nga Samsung Electronics Austria GmbH dega Kroaci i jepet vetëm personave të mëposhtëm:

- Për të dhënat personale të klientëve të mbledhura nëpërmjet faqeve online të krijuara për qëllime marketingu:
 - Përfaqësuesit ligjor të autorizuar të Samsung Electronics Austria GmbH Kroaci.
 - Menaxherët e marketingut, detyra e të cilëve përfshin trajtimin e të dhënave personale të mbledhura për qëllime të caktuara marketingu

14. Informacion i dobishëm kontakti

Ju mund të kontaktoni Shërbimin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në:

Dega Samsung Electronics Austria GmbH Kroaci

Email: Ju lutem na kontaktoni duke dërguar një email në adresën dataprotection.sead@samsung.com